

ka e motit të katundit. Punimi i tokës duhet të jetë më intensiv dhe vetëm me këtë mënyrë do shpëtojnë nga frika e mungesës të bukës së përditëshme.

Agronomët e rinj që janë plot me idealizmë kanë një lëmë të gjërë për studim dhe munt të zgjidhim problemin bujqësor të Mirditës, nga i cili vareti edhe lumtëria e saj. Mos harojmë se edhe Krytarët të Komunave munt të bëjnë shumë punë të mirë në këtë vënt të mjerë.

Kjo gjendje e mjerë do çduket vetëm kur në tokën e keqe të mbillën të lashtat përshatatëse, kur të çilën rrugë edhe shkollat, kur burrat të meren më pak me "pulatikë" dhe t' i përvishen punës me mish e me shpirt dhe, fundazi, kur kryetarët të mos përfitojnë nga padia e tyre dhe t' i përdorin për qëllimet e veta siç ngjiste në kohërat e para. Sa energji njerëzore nuk vete më kot, kurse nga ana tjetër, me udhëheqje të mirë, munt të përdoreshe për shpëtimin vetiak. Për shkolla, rrugë, edhe punëtorë idealistë ka nevojë "Mirdita e Kuqe."